
JETA SHKENCORE

**KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
“MONARKIA SHQIPTARE (1928-1939)”**

Më 1 shtator 2008 Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë organizoi dhe zhvilloi në Tiranë një konferencë shkencore ndërkombëtare me temën “Monarkia shqiptare 1928-1939”. Këtë projekt e financoi Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Konferencës i parapriu hapja e një ekspozite në hollin e Muzeut Historik Kombëtar. Ekspozita ngjalli mjaft interes tek vizitorët e shumë jo vetëm adhurues të monarkisë dhe të Mbretit Zog, por edhe tek shumë intelektualë, historianë, politikanë, artistë, të cilët mjaft nga këto objekte të ekspozuara, i perceptonin për herë të parë.

Në Konferencën “Monarkia shqiptare 1928-1939”, morën pjesë historianë shqiptarë e të huaj nga Britania e Madhe, nga SHBA, nga Franca dhe Italia. Sallën “Iliria” të Hotel Sheraton e kishin mbushur dhe shumë të ftuar nga institucionet e tjera shkencore e akademike nga mbarë vendi, studentë të universiteteve tona si dhe mjaft politikanë për të cilat ngjallte interes tematika e kësaj veprimtarie.

Prof. dr. Bernd Fischer (SHBA) mbajti kumtesën me temë: “Kontributet zogiste në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve”. Autori, studiues i njohur që ka analizuar këtë periudhë historike në një monografi të posaçme, bëri një vlerësim realist e objektiv të të gjithë parametrave të zhvillimit të ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve nën drejtimin e shtetit shqiptar.

Prof. dr. Bajram Xhafa (Universiteti “Luigj Gurakuqi”) shtjelloi në kumtesë me fakte e dokumente “Kushtet historike të krijimit të monarkisë shqiptare”.

Prof. dr. Beqir Meta (Instituti i Historisë) mbajti kumtesën “Politikat e shtetit shqiptar ndaj minoriteteve gjatë periudhës së Ahmet Zogut”. Ai vuri në dukje se shteti shqiptar, si entitet politik i bazuar në tolerancën dhe bashkimin e popullsisë etnike shqiptare të tre besimeve, kultivon bashkëjetesën, në diversitet, duke shmangur fenomenin e eskuzivizmit dhe të hipernacionalizmit. Qëndrimi tolerant dhe luajal ndaj minoriteteve sipas autorit, u konsiderua dhe si një faktor që do të kontribuonte në stabilitetin e shtetit shqiptar. Ky qëndrim ndaj minoriteteve në Shqipëri ishte kontribut jo vetëm i Mbretit, por i tërë politikës shqiptare. Duke e trajtuar qëndrimin ndaj minoriteteve si një politikë të pandryshueshme të shtetit shqiptar, i shërbehej interesave kombëtare. Ky qëndrim ndaj minoriteteve në Shqipëri vlerësohet nga autori si një veçori specifike e nacionalizmit shqiptar në raport me nacionalizmat ballkanikë. Por për fat të keq ka theksuar autori më tej - kësaj politike liberale dhe të mirëkuptimit që ndiqte Shqipëria ndaj minoriteteve, nuk i përgjigjej qëndrimi i fqinjëve të saj, të cilët bënin akuzat të pathemelta ndaj Shqipërisë, për të mbuluar politikën e tyre të kundërt ndaj minoriteteve në vendet e tyre.

Dr. Jason Tomes (Francë) mbajti kumtesën “Ftohja italo-shqiptare 1933-1936”, duke sjellë fakte për të ndriçuar në mënyrë objektive shkaqet e marrëdhënieve të tensionuara midis Shqipërisë dhe Italisë.

Dr. Teodor Kareco (SHBA) mbajti kumtesën “Reforma agrare demokratike e një monarku”. Duke analizuar ligjin e reformës agrare, të kryer në Shqipëri në vitet e monarkisë, ai u përpoq të argumentojë se ajo ishte një reformë demokratike. Me interes u prit nga pjesëmarrësit dhe përjasja që i bëri autori këtij ligji me atë të reformës agrare që bëri qeveria komuniste në Shqipëri pas mbarimit të Luftës II Botërore.

Prof. dr. Francesco Guida (Itali) mbajti temën “Shqipëria” e mbretit Zog, sipas dokumentacionit diplomatik italian”. Mbështetur në burime diplomatike italiane autori paraqiti me kujdes, një këndvështrim të Shqipërisë së asaj periudhe duke zbuluar dhe rolin e mbretit Zog përballë diplomacisë italiane.

Prof. dr. Valentina Duka (Universiteti i Tiranës) trajtoi rrethanat dhe faktorët politikë të brendshme e ndërkombëtare që bënë të domosdoshme ndryshimin e formës politike të shtetit shqiptar nga republikë presidenciale në monarki parlamentare. Kumtesa “Nga presidenca në monarki, çështje të legjitimitetit” iu dha përgjigje disa pikëpamjeve që këtë kalim e kanë konsideruar ilegjitim.

Prof. as. dr. Pranvera Dibra (Arkivi i MPJ, Tiranë) në kumtesën e saj “Kriza e marrëdhënieve shqiptaro-italiane në optikën diplomatike angleze 1931-1934” i kërkoi rrënjët e kësaj krize në synimet strategjike të fashizmit italian, të përgatitjes për luftë në kufijtë e saj, ku në radhë të parë ishte Shqipëria.

Autorja mbështetur në dokumente arkivore, konstaton se qëndrimi e saj ndaj krizës italo-shqiptare Britania e Madhe e kufizoi me njohjen e pozicionit të favorizuar të Italisë në Shqipëri, sipas Rezolutës së Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921. Me politikën që ndoqi Britania e Madhe ndaj kësaj krize përfundon autorja “u provua se Shqipëri ishte përcaktuar të mbetej pjesë e padiskutueshme e interesit politik italian dhe të gjitha shtetet e tjera, duhej ta kishin të qartë këtë rrethanë.

Prof. dr. Muharrem Dezhgiu (Instituti i Historisë) mbajti kumtesën “Politika e Ahmet Zogut në prag dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore”. Autori hodhi dritë mbi përpjekjet e A.Zogut për të luajtur një rol nxitës për qëndresën antifashiste si dhe këmbënguljen e tij për të bashkëpunuar me Aleatët e Mëdhenj në mbrojtje të legjitimitetit të sovranitetit të Shqipërisë. Më tej ai theksoi se edhe në kushtet e kufizimit për veprimtari politike, A. Zogu u pozicionua qartë dhe me vendosmëri në një politikë bashkëpunimi me të gjitha rrymat e emigracionit politik shqiptar, për të gjetur rrugën më të mirë të rivendosjes së pavarësisë së Shqipërisë në fund të luftës. Në fund autori konkludoi se “Pozita politike e Ahmet Zogut gjatë Luftës së Dytë Botërore u minua si nga faktorët ndërkombëtare ashtu dhe nga faktorë të brendshëm të cilët duke vepruar për interesin e vet minuan interesat kombëtare të Shqipërisë.

Bejtullah Destani (Angli) duke analizuar dokumente nga arkivat britanike paraqiti kumtesën “Marrëdhëniet shqiptar-britanike 1929-1939”.

Dr. Halim Purellku (Universiteti i Tetovës) mbajti kumtesën “Veprimtaria e Komitetit të Kosovës në Mbretërinë Shqiptare në vitet 1937-1939”. Autori solli fakte me interes për këtë çështje, duke shpalosur mjaft dokumente nga arkivat maqedonase.

Dr. Iljaz Gogaj (Tiranë) paraqiti kumtesën “Kultura shqiptare gjatë monarkisë”. Autori ka vënë në dukje vizionin e qartë që kishte shteti shqiptar i kohës për zhvillimin kulturor të vendit duke qenë i bindur se “naltësimi i edukimit shpie sigurisht tek ideali kombëtar”. Zhvillimin kulturor të vendit autori e analizon në disa fusha, me përfaqësuesit më të spikatur në këto fusha.

Me interes ishte shqyrtimi që i bën kumtuesi rolit të publicistikës së kohës ku faqet e shtypit u bënë tribunë e shprehjes së mendimit të lirë, ku u hodh fara e një sistemi origjinal filozofik shqiptar që e quajtën neoshqiptarizëm.

Prof. dr. Fatmira Musaj (Instituti i Historisë) trajtoi pozitën e gruas shqiptare në kumtesën “Gruaja në politikën shtetërore të Monarkisë”. Autorja solli një sintezë të problematikës për këtë temë, mbështetur në analizën e fakteve e dokumenteve të bëra më parë në monografinë e saj. Me interes u prit roli i legjislacionit të përpunuar për kohën duke synuar për të ngritur në një nivel të përparuar gjendjen e gruas në Shqipëri. Kjo pozitë juridike e gruas ndikoi edhe në rritjen e rolit të saj në shoqëri.

Prof. dr. Marenglen Verli (Instituti i Historisë) mbajti kumtesën “Interesimi i shtetit shqiptar për shqiptarët në Jugosllavi në vitet 20-30 të shek.XX”. Nëpërmjet dokumenteve të kohës, autori evidentoi faktin se oborri mbretëror dhe qeveritë e kohës i kushtuan një vëmendje të veçantë përpjekjeve për të penguar shpërnguljen e shqiptarëve. Nga ana tjetër, strukturat shtetërore u kushtuan kujdes instalimit të emigrantëve që vinin në Shqipëri. Autori ka vënë në dukje se Tirana zyrtare bëri diferencimin e qëndrimit të saj ndaj kundërshtarëve politikë me trajtimin e çështjes së Kosovës, si problem kombëtar.

Prof. dr. Alberto Basciani (Itali) mbajti kumtesën “Politika kulturore italiane në Shqipëri, ndërmjet dy luftërave botërore.

Prof. dr. Fatmira Rama (Universiteti i Tiranës) ia kushtoi trajtesën e saj qëndrimit të diasporës në vitet e monarkisë. Kumtesa titullohej: “Aspekte të luftës politike në diasporë në vitet e monarkisë”.

Ma. Lavdosh Ahmetaj (Universiteti “Kristal”) mbajti kumtesën “Institucionet qendrore shqiptare dhe monarku”.

Prof. dr. Antonio D’Alessandri (Itali) mbajti kumtesën “Mbreti Zog në historiografinë italiane” ku evidentoi faktin se pak vëmendje i është kushtuar trajtimit të kësaj teme.

Ma. Teki Kurti (Universiteti i Tiranës) paraqiti temën me shumë interes duke trajtuar ‘Aspekte të organizimit dhe veprimtarisë së qeverisje vendore 1928-1939’. Në kumtesë u trajtuan dhe aspekte të bashkëveprimit institucional të qeverisjes vendore me atë të qeverisjes qendrore.

Prof. dr. Dritan Spahiu (Tiranë) mbajti kumtesën “Reforma arsimore e mbretërisë shqiptare”. Me fakte e dokumente të kohës ai analizon shtyllat themelore të kësaj reforme me synim të qartë për të realizuar arsimimin dhe formimin kombëtar të fëmijëve shqiptarë. Edukimi arsimor spikati në fushën e përgatitjes së kuadrit arsimor brenda e jashtë vendit.

Dr. Patrice Najbor (Francë) mbajti kumtesën “Arritjet e mbretit Zog 1928-1939”. Kumtesa e tij është një sintezë e përfundimeve që ka arritur autori, gjatë hartimit të 5 librave kushtuar A. Zogut dhe familjes mbretërore në Shqipëri.

Veç kumtesave që paraqitën mjaft interes për pjesëmarrësit, pati dhe pak diskutime, ku më me interes ishte diskutimi i studiuesit Ferit Këputa. Në diskutimin e tij evidentoi disa momente më të rëndësishme ku spikati roli historik i Ahmet Zogu, sidomos për përpjekjet e tij shtetformuese, ku Shqipëria sipas tij, në ato vite përjetoi vitet e suksesit dhe të evropianizimit real të Shqipërisë në shek. XX, midis botës së qytetëruar evropiane. Ai gjeti pika të përbashkëta përputhjeje të pikëpamjeve të tij me atë të historianit Muharrem Dezhgiu sa i përket përpjekjeve diplomatike të Mbretit Zog

kundër qëllimeve djallëzore e të pabesa të Italisë fashiste ndaj Shqipërisë. Në diskutimin e tij ai tërhoqi vëmendjen e institucioneve shtetërore për një vlerësim më të plotë ndaj veprës së Ahmet Zogut për Shqipërinë dhe shqiptarët, duke bërë dhe propozime konkrete me interes.

Konferenca shkencore ndërkombëtare e para e këtij lloji për historinë e shtetit shqiptar gjatë monarkisë, shënoi një hap të rëndësishëm të mendimit historiografik, që duhet thelluar me studime të plota monografike për shumë çështje të kësaj periudhe historike.

Muharrem DEZHGIU



Pjesëmarrës në konferencë